



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Prot 19/  
12

Tiranë, më <sup>23</sup> 1.2024

Vendim nr. 6 datë 23.1.2024

**“Mbi miratimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2024 për njësitë e përhershme të kërkim studimit”**

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 31.5.2023 Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 821 datë 28.12.2023 Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë, pika 5, vendimit të Kryesisë së ASH nr.4, datë 10.01.2024 “Për strukturën e organikën dhe për emërimin e punonjësve kërkimorë-shkencorë, tekniko-shkencorë dhe të administratës ndihmëse të instituteve të albanologjisë”, shkresës së Ministrisë së Financave nr.469/1, datë 18.01.2024 “Transferim fondi për vitin 2024”,

Kryesia, në mbledhjen e saj të datës 23.1.2024

Vendosi:

1. Miratimin e ndarjes së buxhetit vjetor për vitin 2024 për pagesat e pagave dhe sigurimeve shoqërore të punonjësve kërkimorë-shkencorë ndihmës, tekniko-shkencorë dhe të administratës ndihmëse të instituteve të albanologjisë tani e në vijim me emërtimin “Institetet e Albanologjisë pranë ASH” sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

E.Q	M.L	KOD INST.	EMERTIM INSTIT.	KAPIT.	PROGRAM	LLOG. EKONO MIKE	TDO	KOD PROD.	SHUMA
001	22	1022002	Institetet e Albanologjisë pranë ASH	08	01520	600.0000	3535	92201AF	180,000,000
001	22	1022002	Institetet e Albanologjisë pranë ASH	08	01520	601.0000	3535	92201AF	30,000,000
<b>Totali</b>									<b>210,000,000</b>

2. Ngarkohet Kancelari dhe Sektori i buxhetit dhe financës së ASH për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të zbatohet deri më 31.12.2024.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

